

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Tarraca solare Bashkia Maliq*

”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45210000-2**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”*.Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve duke ju referuar Vendimit Nr.216,datë 13.4.2023 " Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të Çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

VLERA E FONDIT LIMIT:

8.581.761 (tetë milion e pesëqind e tetëdhjet e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjet e një) lekë pa tvsh

9.315.793 (nëntë milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjet e tre) lekë me tvsh

I ndarë në

-Punime Ndërtimi :

3.670.161 (tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjet mijë e njëqind e gjashtëdhjet e një) lekë pa tvsh

4.404.193 (katër milion e katërqind e katër mijë e njëqind e nëntëdhjet e tre)lekë me tvsh

-Pajisje: **4.911.600** (katër milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë

Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas Vendimit Nr.216,datë 13.4.2023 " Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të Çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2024 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jete jo më të vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat.30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A (punime germimi ne toke)
2. NP 3 - A (rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada)
3. NP 10 - A (ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise)
4. NP 11 - A (ndertime per N/stacionet kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise)
5. NS 3 - A (impiante ngritese dhe transpostues ashensore,shkalle levizese,transportues)
6. NS 4 - A (punime te rifinitures te muratures dhe te lidhura me to)
7. NS 8 - A (ndertime parafabrikat beton arme struktura metalike dhe druri)
8. NS 14 - A (impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV etj)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në baze të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë

28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatese	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatese
NP 1	<i>punime germimi ne toke</i>		A	
NP 3	<i>rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada</i>		A	
NP 10	<i>ndertimi i impianteve per prodhimin e energji</i>		A	
NP 11	<i>ndertime per N/stacionet kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energji</i>		A	
NS 3	<i>impiante ngritese dhe transpostues ashensore,shkalle levizese,transportues</i>		A	
NS 4	<i>punime te rifinitures te muratures dhe te lidhura me to</i>		A	
NS 8	<i>ndertime parafabrikat beton arme struktura metalike dhe druri</i>		A	
NS 14	<i>impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV etj</i>		A	

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate ne formularin permbledhes te vetedeklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të**

punimeve në objekt, i cili duhet të jetë të perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete :

- Inxhinier elektrik (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Ndertimi (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për *“Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhënë nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht quhet i plotësuar edhe kur vetem 1 operator ekonomik paraqit dokumentat per punonjesin e pajisur me certifikate trajnimi për “Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”.*

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, “Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c. Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier elektrik. Gjithashtu bazuar në zerrat e preventivit është domosdoshme që të kemi dhe staf mbështetës për realizimin e punimeve si inxhinieri I ndertimit dhe inxhinieri mekanik.

2.3.5 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë", si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 6 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Murator** (1)
- **Elektricitist** (2)
- **Saldator** (1)

"Për punonjësit e mësipërm në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);
ose
Deshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Punetore të thjeshte** (2)

"Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

- **Murator**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit, punime betoni ,punime trotuare ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 1 murator i cili do të realizojne këto punime.

- **Elektricitist**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit per te gjitha punimet elektrike ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 2 elektricitist.

- **Punetore te thjeshte**

Jane kerkuar 2 punetore te thjeshte per te kryer punimet sipas preventivit dhe grafikut te percaktuar.

- **Saldator**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit, kërkohet që operartori ekonomik të disponojë 1 saldator per realizimin e punimeve per konstruksionet metalike

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënimi-argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.6 Një punësim mesatar i të paktën 6 punonjësish për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
Dhe
- b. **Listpagesat** e konfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Kriteret e percaktuara në pikën 2.3.7. Eshtë kërkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 6 punonjësish për të realizuar punimet ,nga zërimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” .

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 6 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të

cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Zberthimi

ZBERTHIM PUNIMESH

Objekti:Tarraca solare, Bashkia Maliq

Nr	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	Njesi	Sasi	op/ njesi	op/ gjith
		1. PUNIME GERMIMI				
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	60	0.11	6.60
2	3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m3	20	6.05	121.00
		SHUMA 1:				0.00
		2. PUNIME DHEU				0.00
3	2.19	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III	m3	25	1.25	31.25
4	2.38	Transport mbeturinash me karoce dore ne largesi 10m	m3	55	1.0	55.00
		SHUMA 2:				0.00
		3. INSTALIME PER NDRICIM				0.00
5	2.455	F.V. Kanaline metalike 150x50	ml	30	0.30	9.00
6	2.456	F.V. Kanaline metalike 210x65	ml	60	0.30	18.00
7	2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	copë	3	0.30	0.90
		SHUMA 3:				0.00
		4. PUNIME SHITRESASH 2				0.00
8	2.261	Shtrese rere	m3	20	0.87	17.40
		SHUMA 4:				0.00
		5. NENSHTRESA DHE SHITRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE				0.00
9	2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	m2	20	2.40	48.00
10	2.294/ 1	Heqje pllaka betoni trotuari ekzistues	m2	20	2.00	40.00

		SHUMA 5:				0.00
		6. ANALIZA JASHTE LISTE				0.00
11	AnAn1.1	Instalim impiant fotovoltai	kw	90	1.00	90.00
12	AnAn1.2	Montim strukture fiksime alumini	kg	1100	0.48	528.00
13	AnAn1.3	Montim karikues makinash Fast Charging 80 kW	copë	1	10.00	10.00
14	AnAn1.4	Hapje dhe mbyllje kanali per kabllot e fuqise thellesi 1.2 m	ml	95	0.74	70.30
15	AnAn1.5	Vinc	op	45	1.00	45.00
16	AnAn1.6	Kabell Fuqie Baker 5x25mm ²	ml	80	0.20	16.00
17	AnAn1.7	Profile alumini + bulloneri fiksime ne Beton	kg	400	0.48	192.00
18	AnAn1.8	Struktura fiksime betoni per Panel Solar	copë	165	0.20	33.00
19	AnAn1.9	Mesore AL	kg	20	0.48	9.60
20	AnAn1.10	Struktura Metalike Fiksime per Invertera	copë	2	10.00	20.00
21	AnAn1.11	Kabell Solar 6mm 1500v (kuq)	ml	500	0.20	100.00
22	AnAn1.12	Kabell Solar 6mm 1500v(zi)	ml	500	0.20	100.00
23	AnAn1.13	Konektore (+)	copë	20	10.00	200.00
24	AnAn1.14	Konektore (-)	copë	20	10.00	200.00
25	AnAn1.15	Fundore AL	kg	10	0.48	4.80
26	AnAn1.16	Tub plastik per kablo fuqie	ml	80	0.20	16.00
27	AnAn1.17	Percjelles tokezime per strukturat metalike dhe aksesore fiksime	kg	45	0.48	21.60
28	AnAn1.18	Puseta elektrike 30x30x30cm	copë	3	2.50	7.50
29	AnAn1.19	Kabell Data dhe aksesore	komplet	1	10.00	10.00
30	AnAn1.20	Kimike dhe aksesore te ndryshme fiksime	komplet	1	10.00	10.00
31	AnAn1.21	Kabell bakrri 5x70mm ² per karikuesin e makinave	ml	80	0.20	16.00
32	AnAn1.22	Bazament fiksime per karikuesin 80kW	copë	1	10.00	10.00
33	AnAn1.23	Tub plastik per kablo fuqie D200mm	ml	75	0.20	15.00

34	AnAn1. 24	Sinjalistike mbrojetese ne kanal tulla + shirit	ml	95	0.20	19.00
SHUMA 6:						2,090.95

- *Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 2091*
- *Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore 2091 : 8 = 262
kemi 262 punëtorë për një ditë pune*
- *262 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 12 punëtorë për një muaj punë.*
- *Sipas grafikut te punimeve per dy muaj duhen 6 punonjes*